



Prishtinë: 15.06.2015
Kodi i ZRRE-së: V_740_2015

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1304_02_15**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **02.05.2015**.

në seancën e mbajtur më datë 15 qershor 2015, nxori këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e konsumatorit H. K (parashtruesi V. K.) me shifër DPR - 121039 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II Mbetet në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1304_02_15** i datës 11.02.2015.

A r s y e t i m

Me datë 24.07.2012 punëtorët e autorizuar të kontrollës kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe gjatë inspektimit kanë konstatuar se njehsori elektrik nr. 7862289 me gjendje TL=44682 kWh dhe TU=33493 kWh duhet të merret në kalibrim. Pas kësaj në po të njëjtën ditë, pra më 24.07.2012 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë dalur te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 7862289 me gjendje TL=44682 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=33493 kWh (tarifa e ulët) dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 62261258 me gjendje TL=000006 kWh dhe TU=000006 kWh. Në këtë procesverbal punëtorët e autorizuar të KEK-ut përveç ndërrimit të njehsorit kanë theksuar se ndërrimi i njehsorit bëhet me proces nr. 1224537, ku njehsori paraprak merret dhe dërgohet në qendrën e kalibrimit për verifikim dhe montohet njehsori i KEK-u, si dhe kanë evidentuar pajisjet elektrike të cilat i posedon konsumatori.

Departamenti i faturimit në KEDS me datë 05.09.2012 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën gusht 2012 me shpenzim prej 4,646 kWh apo e shprehur në vlerë financiare **332.77€**.

Me datë 11.09.2012 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEDS duke kundërshtuar se faturimin për shkak të ngarkesës me mbi limit so dhe ka kërkuar që të rishikohet borxhi pasi që është paguar në muajin gusht komplet , ndërsa tani ka arritur vlera prej 332.77€ paushall.



Me datë 21.06.2014 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë dalur te konsumatori dhe kanë inspektuar pikën matëse dhe gjatë inspektimit kanë konstatuar se objekti ku është ky konsumator është i rrënuar por është në ndërtim e sipër.

Me datë 16.02.2013 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, dhe kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 17667911, ku TL=55033 kWh (tarifa e lartë) dhe TU= 00002 kWh (tarifa e ulët). Pas kësaj Departamenti për Konsumator në KEK me datë 16.02.2013 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në listat e leximit, si dhe rrjedhës së energjisë elektrike. Konsumatori përgjigjën e ka pranuar me datë 27.01.2014.

Me datë 21.06.2014 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë dalur te konsumatori dhe kanë inspektuar pikën matëse dhe gjatë inspektimit kanë konstatuar se njehsori elektrik i konsumatorit ka qenë pasiv pasi që objekti ka qenë në rrënim, mirëpo konsumatori e ka rindërtuar objektin dhe ka bërë kërkesë me datën 09.06.2014 që t'i aktivizohet njehsori elektrik (shifra) pasi që konsumatori ka shpenzim si dhe bllobohet njehsori me bllomba distributive të KEDS-it.

Me datë 04.07.2014 Departamenti për Konsumator në KEDS i është përgjigjur konsumatorit duke e aprovuar ankesën e tij dhe duke e korrigjuar konsumatorin në vlerë prej -39.37€, duke bërë korrigjimin e faturave prej periudhës 04/2012 e deri më 08/2012 për shkak të leximit jo të rregullt.

DMK ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 11.02.2015 ka nxjerr vendimin duke e aprovuar ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEDS-i që: 1) të shkarkon konsumatorin me shifër DPR – 121039 nga korrigjimi nr. 43941DPR-121039-121039 i datës 17.10.2012 në vlerë prej -39.37€; 2) të korrigjon konsumatorin me shifër DPR – 121039 për faturën nr. 0812115016DPR-121039 të datës 05.09.2012 me shpenzim prej 4,646 kWh apo e shprehur në vlerë financiare 332.77€ në vlerë prej -260.71€, ashtu që të bëjë shpërndarjen e shpenzimit të energjisë elektrike (kWh) nga periudha prej periudhës 02/2004 e deri më periudhën 08/2012; dhe 3) të shkarkon konsumatorin me shifër DPR – 121039 nga faturat e energjisë elektrike prej periudhës 09/2012 e deri më 03/2013.

Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se është i pakënaqur me vendimin e DMK të ZRRE-së, dhe në ankesë ka parashtruar dy pika për aprovim. Në pikën 1 të ankesës konsumatori ka kërkuar që pika e 3 e vendimit të ZRRE të korrigjohet nga periudha 02, 03/2013 dhe deri më 10.06.2014. Në pikën dy të ankesës konsumatori ka kërkuar që të shkarkohet borxhi i energjisë elektrike në tërësi pasi KEDS-po heziton të shlyej borxhin prej 112€.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 15 qershor 2015 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit, përkatësisht bazën e kundërshtimit të tij në ankesë dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se argumentet e prezantuara nga ana e konsumatorit nuk janë bindëse për faktin se me asnjë provë nuk ka argumentuar se DMK ka dëmtuar konsumatorin financiarisht gjatë vendosjes së kësaj çështje.

Sa i përket pikës së parë të kundërshtimit nga ana e konsumatorit që pika e 3 e vendimit të ZRRE të të ndryshohet dhe të korrigjohet nga periudha 02, 03/2013 dhe deri më 10.06.2014, Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se në pikën 3 të vendimit të DMK ku është theksuar se KESCO obligohet të shkarkon konsumatorin me shifër DPR – 121039 nga faturat e energjisë elektrike prej periudhës 09/2012 e deri më 03/2013 është gabim teknik, ngase në arsyetimin e vendimit të DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_1304_02_2015 të datës 11.02.2015 është theksuar se KESCO duhet të shkarkoj konsumatorin nga faturat e energjisë elektrike prej periudhës 09/2012 e deri më 03/2014 dhe se për këtë periudhë KEDS-i do të bëjë korrigjimin e faturave të energjisë elektrike. Pra lidhur me këtë Bordi



i ZRRE-së, ka konstatuar se përveç gabimit teknik që është bërë në pikën 3 të këtij vendimi në evidentimin e periudhës, vendimi i DMK-së është bërë konform rregullave dhe procedurave në fuqi.

Lidhur me pikën e dytë të kundërshtimit ku konsumatori ka kërkuar që të shkarkohet nga borxhi i tërësishëm i energjisë elektrike në vlerë prej 112€, Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se konsumatorit nuk i takon korrigjim tjetër përveç korrigjimi të bërë në pikën 2 të vendimit të DMK ku konsumatori është korrigjuar në vlerë prej -260.71€. Bordi i ZRRE-së gjatë analizimit të lëndës së konsumatorit ka vërejtur se edhe përkundër asaj që konsumatori me datë 10.07.2012 ka bërë një pagesë të energjisë elektrike në vlerë prej 146€ ku pas kësaj pagese borxhi i përgjithshëm i energjisë elektrike ka qenë -2.29€, dhe në atë periudhë konsumatori ka kërkuar nga KEK-u pasivizim të shifrës DPR – 121039, kur punëtorët e autorizuar të KEK-ut gjatë procesverbalit të ndërrimit të njehsorit elektrik nr. 009608 të datës 24.07.2012 gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike në tarifën e ulët nuk përputhet me gjendjen e evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike aktive, dhe se ajo mos përputhje është për 4,761 kWh më e lartë në rrjedhën e energjisë elektrike se sa në vërtetimin e ndërrimit të njehsorit elektrik. Bordi i ZRRE gjatë analizimit të procesverbalit të ndërrimit të njehsorit elektrik dhe rrjedhës së energjisë elektrike kanë vërejtur se kjo mospërputhje e gjendjes së tarifës së ulët nuk përputhet që nga periudha 02/2004, pra sipas kësaj del se nga periudha 02/2004 e deri më 24.07.2012 punëtorët e autorizuar të KEK-ut nuk kanë bërë lexim të saktë të njehsorit elektrik nr. 7862289. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se KEK-u është dashur që me rastin e ndërrimit të njehsorit elektrik, kur ka evidentuar gjendjen e saktë të njehsorit elektrik nr. 7862289, të bëjë korrigjimin e saktë të faturave të energjisë elektrike dhe atë prej periudhës 02/2004 e deri më 24.07.2012 dhe pastaj të shikoj nëse konsumatori ka bërë kërkesë për pasivizim të njehsorit elektrik ta pasivizoj atë shifër deri në kërkesën për aktivizim të saj, e jo të bëjë korrigjimin gabim dhe të vazhdoj të faturoj me fatura të energjisë elektrike. Pra, Bordi i ZRRE-së thekson se edhe përkundër asaj që KEK-u ka gabuar kur nuk ka bërë lexim të rregullt prej periudhës 02/2004 e deri më 24.07.2012, gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike (kilovatorët) me rastin e ndërrimit të njehsorit elektrik nuk duhet të neglizhohen, pasi që konsumatori atë shpenzim të energjisë elektrike e ka shpenzuar dhe si të tillë duhet edhe ta paguaj. Andaj Bordi i ZRRE-së konstaton se korrigjimi i DMK-së prej në vlerë prej -260.71€ ku është bërë shpërndarja e shpenzimit të energjisë elektrike prej periudhës 02/2004 e deri te vërtetimi i ndërrimit të njehsorit elektrik i datës 24.07.2012 është korrigjim i saktë.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 15.06.2015 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1304_02_15, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar